



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 486/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaçi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit Nisma-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. PRANOHET** pjesërisht e bazuar ankesa Anr. 486/2019 e datës 16.11.2019, e paraqitur nga Koalicionit Nisma-AKR-PD, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 (një) fletëvotim në Vendvotimin 0402D/08D, të vlerësohet i vlefshëm, dhe i njëjti ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

**II. REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr. 486/2019 e datës 16.11.2019, në pjesën që ka kërkuar ankuesi që në secilën nga Vendvotimet, 0403X/06D dhe 0819C/01D, të shpallet nga 1 (një) fletëvotim i vlefshëm.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 16.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.486/2019 nga subjektit politik koalicionit Nisma-Akr-Pd, në të cilën pretendohet se më 15.11.2019 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutitë e votimit 0403X/06D, 0402D/08, 0819C/01D janë shpallur tri fletëvotime të pavlefshme në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës zgjedhore 06/2013, duke përcaktuar kritere shtesë të cilat nuk janë të parapara me dispozitat e rregullës në fjalë. Sipas parashtresës të ankesës KQZ-ja i ka shpallur të pavlefshme këto tri fletëvotime me arsyetimin se në rastin e parë në rubriken e subjektit politik PDK vërehet një pik e cila është e lëshuar nga printeri, kurse në rubrikën e subjektit politik koalicionit Nisma-Akr-Pd është e vendosur shenja “TIK”, te rasti i dytë në rubriken e subjektit politik VAKAT po ashtu vërehet një pik, kurse në rubrikën e subjektit politik koalicionit Nisma-Akr-Pd është e vendosur shenja “TIK”, ndërsa te rasti i tretë kemi të bëjmë me lëshim ngjyre nga vula e KQZ-së, në kolonën e subjektit politik KOSOVALI NEVI ROMANI PARTIA, mirëpo shenja “TIK” është e vendosur në rubrikën e subjektit politik koalicionir Nisma-Akr-Pd, nga pretendimet e

lartecakura në asnjë mënyrë nuk nënkupton se këto fletëvotime duhet të shpallen të pavlefshme nga ana e KQZ-së.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 17.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ( KQZ), thekson se ligji për zgjedhjet thot se fletvotim shpallet i vlefshëm në rast se dihet qëllimi i qartë i votuesit. Mirëpo kemi raste kur në fletëvotimi është shenuar Subjekti dhe tek një subjekt tjetër kemi një pikë që në bazë të doracakut e kategorizon si të pavlefshme, por ajo pikë apo shenja e dytë tek Subjekti tjetër është shumë e vogël milimetrike. Në të gjitha rastet kur shihet se pika është nga printeri apo ndonjë ngjyrë tjetër përpos stilografit , ai fletëvotim është shpallur i vlefshëm por kemi raste kur edhe pse ajo pikë është shumë milimetrike por është gjurmë stilografit dhe ai fletëvotim bazuar në doracak shpallët i pavlefshëm .

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është pjesërisht e bazuar**

Prendendimet e ankuesit se në Vendvotimet, 0403X/06D, 0402D/08, 0819C/01D, janë shpallur nga ana e QNR-së, 3 fletëvotime të pavlefshme, për shkak se një pikë është vendosur në rubrikën e subjektit tjetër e ndërsa shenja tik është vendosur në rubrikën e subjektit politik Nisma – Akr – Pd, ndërsa në rastin tjetër është lëshuar ngjyra e vulës së KQZ në rubrikën e një subjekti tjetër ndërsa shenja “TIK” është vendosur në rubrikën e subjektit politik Nisma – Akr – Pd. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit i ka shpallur të pavlefshme këto fletëvotime.

Koalicioni Nisma – Akr – Pd, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor kur ka kërkuar nga PZAP-i, që këto fletëvotime të shpallen të vlefshme sepse të metat apo gabimet të cilat i referohet QNR-ja nuk janë kritere që e bëjnë të pa vlefshëm një fletëvotim.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, përgjigjes në ankesë, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit ashtu që pa të drejtë 1 (një) fletëvotim i gjetur në kutin 0402D/08, është shpallur i pa vlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtës ka rezultuar se nuk e përmbushin asnjërin kriter të pa vlefshmërisë dhe të njëjtin, duhet të llogaritet si i vlefshëm dhe rezultatet i të njëjtit duhet t'i bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019, ashtu siç është vendosur në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës së ankesës që është refuzuar, paneli konstatoi nga hetimet e bëra në QNR, se në Vendvotimin 0819C/01D dhe në Vendvotimin 0403X/06D, respektivisht në dengun

e fletëvotimeve të pavlefshme, nuk është gjetur as një fletëvotim i pavlefshëm që i për ketë ankuesit, andaj ka vendosur si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga vlefshmëria e fletëvotimit të vendosur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, e të cilin fletëvotim e gjeni të bashkangjitura me këtë vendim, duhet të përfshihet në rezultatin e publikuar përfundimtar të shpallur me datë 07.11.2019.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr. 486/2019 më datën 18.11.2019**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***

**ZGJEDHJET E PARLAMENTIT  
PËR KOSOVON  
2019**

Shënim: VETËM NJË subjekt politik  
Ora të shtesë të votimit  
BADECE BIR: shtesë kurullorë të votimit

**04.02.2019**

**REPUBLIKË E KOSOVËS 2019  
PUBLIKE KOSOVO 2019  
I ERKEN SEÇJINLERI**

Shënim: Në të shumtën e rasteve  
për të cilat është përdorur  
EN FALA BIR shtesë kurullorë

|     |     |     |     |
|-----|-----|-----|-----|
| 1   | 2   | 3   | 4   |
| 5   | 6   | 7   | 8   |
| 9   | 10  | 11  | 12  |
| 13  | 14  | 15  | 16  |
| 17  | 18  | 19  | 20  |
| 21  | 22  | 23  | 24  |
| 25  | 26  | 27  | 28  |
| 29  | 30  | 31  | 32  |
| 33  | 34  | 35  | 36  |
| 37  | 38  | 39  | 40  |
| 41  | 42  | 43  | 44  |
| 45  | 46  | 47  | 48  |
| 49  | 50  | 51  | 52  |
| 53  | 54  | 55  | 56  |
| 57  | 58  | 59  | 60  |
| 61  | 62  | 63  | 64  |
| 65  | 66  | 67  | 68  |
| 69  | 70  | 71  | 72  |
| 73  | 74  | 75  | 76  |
| 77  | 78  | 79  | 80  |
| 81  | 82  | 83  | 84  |
| 85  | 86  | 87  | 88  |
| 89  | 90  | 91  | 92  |
| 93  | 94  | 95  | 96  |
| 97  | 98  | 99  | 100 |
| 101 | 102 | 103 | 104 |
| 105 | 106 | 107 | 108 |
| 109 | 110 |     |     |

- 111.  PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE
- 112.  PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PKK
- 113.  PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAJ
- 114.  STRANKA DEMOKRATISKE AKCIJE - SDA
- 115.  PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS
- 116.  PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK
- 117.  POKRET ZA GORA - PG
- 118.  NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
- 119.  AAK -  PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË
- 120.  SLOBODA
- 121.  SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SILS
- 122.  NSMA SOCIALDEMOKRATË  ALEANCA KOSOVA E RE  PARTIA E DREJTËSISE
- 123.  JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- 124.  KOALICIA VAKAT
- 125.  FJALA
- 126.  LËVIZJA VETËVENDOSJEI
- 127.  KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KDTP
- 128.  PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- 129.  PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- 130.  KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
- 131.  INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- 132.  EMIR KASI
- 133.  GRADANSKA INICIJATIVA GORE - GIG
- 134.  LIQIJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- 135.  SRPSKA LISTA